



PROCESVERBALI

Mbledhja e **Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)** - Rahovec, e mbajtur më **31.1.2024**, me fillim në orën **15:00**. Mbledhjen e kryesoi kryetari i Komunës, z. **Smajl Latifi**. Për mbajtjen e mbledhjes, kuorumi ekziston. **Kryetari:** Më lejoni t'i përshëndes anëtarët e KKSB-së, drejtorët e drejtorive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec, z. Fazli Morina, përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit e FSK-së, të shoqërisë civile, të bizneseve, të komuniteteve pakicë, të OSBE-së, të KFOR-it, të LMT-së dhe mediet. Është mbledhja e **parë** e rregullt për vitin 2024. Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

Rend Dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Analizë e sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit për vitin paraprak 2023;
3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;
 - Siguria në trafik,
 - Ushtrimi i kontrollit më të shpeshtë të trafikut rrugor për të zvogëluar aksidentet me fatalitet.
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit.
4. Trajtimi i qenve endacakë;
5. Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje;
6. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme;
7. Organizimi i trajnimit për mbrojtje nga zjarri me nxënësit e shkollave;
8. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat;
9. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;
10. Të ndryshme.

Kryetari: Atëherë, besoj që materialin e keni pranuar me kohë. Kemi një plan të ri të angazhimeve dhe të përkushtimeve si KKSB. Nëse keni vërejte apo koment rreth rendit të ditës, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Njëzëri kalon rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryetari: A keni ndonjë koment apo vërejtje rreth procesverbalit? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”?... a kemi votë kundër?... Konstatojmë që është miratuar pika e parë e rendit të ditës.

2. Analizë e sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit për vitin paraprak 2023:

Kryetari: Ne e kemi përcjellë me vëmendje dhe e kemi pasur si temë në vazhdimësi sigurinë e përgjithshme në komunën tonë. Kontributi i komandantit të stacionit të policisë dhe i të gjithë anëtarëve është evident edhe gjatë kësaj periudhe njëvjeçare, kemi ardhur në përfundim që gjendja e sigurisë në komunën tonë është stabile dhe pa cenime. Qytetarët e komunës sonë kanë një vetëdije të lartë, sepse kanë dëshmuar që interesi i përgjithshëm është me prioritet.

3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit:

Fazli Morina: I nderuar kryetar, të nderuar anëtarë të KKSB-së, pjesëtarë të FSK-së, të kultit fetar, përshëndetje për të gjithë! Raportimi është prej takimit të fundit të KKSB-së, e deri më sot. Situata e sigurisë në Komunën e Rahovecit është e njëjtë, e qetë dhe stabile. Janë implementuar dhe vazhdojnë të implementohen 3 strategji, 7

urdhëresa, 14 plane të veprimit, 2 projekte dhe një fushatë sensibilizuese. Gjatë kësaj kohe, në stacionin policor në Rahovec, janë regjistruar 76 vepra penale, zero incidente jopenale. Nga trajtimet e të gjitha rasteve, 13 persona janë arrestuar, ndërsa 8 persona janë ndalur në mbajtje. Nga ekipi me ndërlidhje me gjykata, janë realizuar 50 urdhëresa të gjykatës. Janë shënuar 1230 gjoba për kundërvajtje në komunikacion rrugor, 35 gjoba pa patentë shofer, 214 gjoba për parking ilegal, 20 gjoba për përdorim të telefonit gjatë vozitjes dhe 9 gjoba për prishje të rendit dhe të qetësisë publike. Te aksidentet e trafikut: Janë 13 aksidente me dëme materiale të trajtuara nga SP Rahovec. Në zyrën e SIPK-ut (Sistemi Informativ i PK), gjatë periudhës raportuese janë paraqitur 648 kërkesa për të kaluarën kriminale dhe 421 vërtetime mbi humbjen e dokumenteve. Te siguria në shkolla: Gjatë kësaj periudhe raportuese, situata ka qenë e qetë dhe stabile. Gjatë kësaj periudhe raportuese është rritur edhe numri i patrullimeve rreth kulteve fetare, janë realizuar rreth 1251 patrullime. Janë mbajtur tri tubime nga komuniteti serb, më datë 4, 6 dhe 13 janar në Hoçë të Madhe dhe Zaqisht. Çdo gjë ka kaluar në rregull. Janë raportuar 4 raste të raportuara, lëndim i lehtë trupor në ShFMU “Isa Boletini” Rahovec, lëndim i rëndë trupor në Shkollën e Mesme “12 Maji” në Ratkoc, dështim dhe asgjësim i pronës në “Selajdin Mullabazi – Mici” në Rahovec dhe vjedhje e rëndë në Shkollën “Isa Boletini” në Rahovec. Kjo është e tëra për periudhën raportuese prej takimit të fundit të KKSB-së. Sa u përket qenve endacakë, kemi të paraqitura 6 raste, 5 lëndime të lehta trupore dhe një rast ka mbetur i hapur për hetim.

Kryetari: Faleminderit komandant për këtë evidencë dhe për këtë analizë! Mund të konsiderojmë që në komunën tonë ka pasur stabilitet dhe siguria e përgjithshme ka qenë e qetë.

Erseka Cana: I nderuar Kryetar i Komunës, z. Smajl Latifi, nënkryetar z. Fatmir Iska, të nderuar anëtarë të KKSB-së! Dua të flas për një çështje me të cilën përballen çdo ditë prindërit që i kanë fëmijët e tyre në çerdhen “Tulipanët”. Në rrugën “Muharrem Dina”, qëndrojnë shumë vetura të parkuara dhe e kemi të pamundur lëvizjen në atë rrugë. Gjithashtu kam pranuar shumë shqetësime nga prindërit, të cilët thonë që veturat qëndrojnë aty me ditë e me javë të tëra. Për shkak të trafikut të ngarkuar në atë rrugë, ndodhin edhe vonesat në çerdhe. Ftoj Drejtorinë për Shërbime Publike, Drejtorinë për Punë Inspektuese dhe policinë, që të ndër marrin ndonjë masë për ta liruar këtë rrugë dhe të gjendet një zgjidhje për të lëvizur më lehtë në të dyja pjesët. Problemi kyç është që të evitohet ndonjë fatalitet të mundshëm. Faleminderit për mirëkuptimin tuaj!

Shaip Shala: Faleminderit, kryetar! Faleminderit për raportin, komandant! Përshëndetje për kolegët dhe monitoruesit! Në çdo mbledhje e diskutojmë dhunën familjare. Policia, sipas kompetencave, po e kryen punën e vet, me ndalesa 24 ose 48 orë. Rastet po procedohen në gjykatë dhe gjykata është ajo që e ka përgjegjësinë e fajësisë në rritjen e rasteve përsëritëse të dhunës familjare. Pse?... Sepse me dënime të buta (më kusht, gjobë, tolerancë, lirim), po trimërojnë dhunuesit që të vazhdojnë punën e tyre. Këtë që po e them, po i atribuohem rastit më të freskët, që një dhunues i vazhdueshëm u dënua vetëm me 4 muaj. Burgu e ka socializuar personin në fjalë dhe tani është bërë i butë si pambuk. Ky nuk është problem vetëm në Rahovec, është i përgjithshëm. Rasti tragjik në Podujevë ka ndodhur nga përsëritësi. Besoj që edhe ne si KKSB mund të ndikojmë që, përmes debateve të ndryshme konstruktive me gjykatës e prokurorë (2 herë në vit), dënimet të ashpërsohen. Këtu jemi disa që e kemi përjetuar edhe kushtetutën 1974, e cila në vete ka një sistem të drejtësisë më të mirë sesa ky që është sot. Ka ekzistuar gjykata për kundërvajtje. Më 1991, më kanë zënë në flagrancë si aktivist. Në veturë po më pyesnin, a e din çka po të pret. Ia ktheva duke thënë që po, minimum dy muaj. Në mbrëmje shkova në burg si faqebardhë për çështje kombëtare.

Mustafë Korenica: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sot në takimin e parë të këtij viti. Është në pyetje siguria në trafik. Komandanti raportoi dhe përmendi një pikë shqetësuese, afër 30 raste pa patentë shofer. Kjo është një pikë brengosëse, që mua si Mustafë Korenica si shqiptar i këtij qyteti më shqetëson. Të rinjtë tanë mund të jenë shkaktarë shumë të dëmshëm në jetën tonë të përditshme.

Fazli Morina: Faleminderit, Shaip! Po filloj te rastet e dhunës në familje. Nuk duhet bazuar shumë në shifra që kanë ndodhur këtu, numri nuk është në rritje sepse janë raste ripërsëritëse. Për pakënaqësinë rreth dënimeve të buta, nuk është në kompetencën tonë. Te Erseka, pjesa e parkut atje poshtë, besoj që është kompetencë e Inspeksionit. Automjetet sigurisht nuk janë të parkuara në rrugë, por janë në vendparking. Çështje tjetër është se kush i parkon veturat aty, unë apo, ai tjetri, që nga mëngjesi, apo 24 orë. Propozoj që në atë pjesë atje të merret Drejtoria e Inspeksionit. Te vozitësit pa patentë shofer dhe shifra që e raportova, është shumë e vogël në krahasim më atë që ndodh në realitet.

Nora Boshnjaku: Përshëndetje për të gjithë anëtarët e KKSBB-së, kryetarin, komandantin, nënkryetarin, kolegë drejtorë! Gjithashtu edhe ne si Drejtori e Inspektoratit, jemi të njoftuar me problematikën që është afër çerdhes “Tulipanët”. Përveç shfrytëzimit të pronës publike, ka edhe vetura që parkohen në vazhdimësi nga qytetarët që pinë kafe aty afër. Njëjtë edhe për banorët të cilët jetojnë në atë lagje dhe ata që i marrin fëmijët e tyre në çerdhe. Kompetencat e Inspektoratit i kemi shumë të qarta, mirëpo dihet që sigurinë në komunikacionin rrugor dhe parkimin pa leje e monitoron Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit Rrugor. Monitorimin e veturave dhe parkimin pa vend nuk kemi mundësi ta realizojmë.

Kryetari: Faleminderit për kontributin! Parkingjet të cilat keqpërdoren te rruga “Muharrem Dina”, e lus policinë, sepse e kanë edhe një zyrtar policor aty që bën probleme. Unë flas hapur dhe veturat duhet të largohen prej aty. Kërkoj që të largohen veturat që nuk e kanë vendin aty. Kërkoj nga Inspektorati dhe nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, të shënjojnë parkingjet nëse nuk janë të shënuara. Policia e Kosovës së pari duhet t’ia tregojë vendin zyrtarit policor që bën probleme. Përfundimisht, parkingjet dhe hapësira publike aty nuk do të keqpërdoren dhe nuk bën të bllokohet rruga. Rruga në fjalë është pjesë e projektit të sheshit, deri sa të intervenohet aty, unë kërkoj masa nga tri organe: Policia dhe Inspektorati dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike. Ata që kanë autolarje aty, le të punojnë dhe fitojnë, por sidoqoftë nuk ka nevojë të ketë përplasje në pronën publike. Sa i përket Shaipit, është mirë që për recidivistët ta ngrenë zërin nga kjo foltore dhe në emër të qytetarëve i ftoj organet kompetente ta kryejnë punën në mënyrën më të mirë të mundshme. Sa më shumë bashkëpunim dhe raportim, ne e mbrojmë veten më mirë dhe njëkohësisht e rrisim sigurinë.

4. Trajtimi i qenve endacakë:

Kryetari: Fillimisht ju them që e kemi një kontratë aktive për trajtimin e qenve endacakë. E ftoj Beratin të tregojë se ku jemi me këtë kontratë.

Berat Duraku: Faleminderit, kryetar! Të nderuar anëtarë të KKSBB-së! Duke u bazuar në kërkesa të shumta dhe rrezikun që është shfaqur në territorin e komunës sonë, në majin e vitit 2023 kemi lidhur një kontratë për trajtimin e 1000 qenve endacakë. Kontrata është e paraparë të zbatohet për tri vjet. Sipas raportit të veterinarit të specializuar, deri më tani janë trajtuar 321 qenë dhe kontrata është duke vazhduar edhe këtë vit dhe vitin e ardhshëm. Jo çdo qen që e shohim në rrugë kemi të drejtë ta eliminojmë, në bazë të kontratës janë të specifikuar të gjitha pozicionet. Qëllimi kryesor është vaksinimi, po ashtu edhe kastrimi i tyre.

Kryetari: Faleminderit! Operatori vepron në përputhje me shqetësimet që i paraqesim. Kontrata ka kufizime për shkak të ligjit për mbrojtjen dhe trajtimin e kafshëve. Berati, m’u duk që e bëri një “lapsus” të vogël kur e përmendi fjalën “eliminim”. Ne nuk eliminojmë qenë endacakë, sepse nuk kemi të drejtë ligjore. Ne i trajtojmë qentë endacakë. Komuna jonë ka filluar me këtë kontratë, por kjo nuk do të thotë që edhe komunat e tjera i trajtojnë. Ne nuk jemi shumë të sigurt që jemi duke i trajtuar vetëm qentë që i kemi gjetur në komunë të Rahovecit, sepse ka njerëz të tillë që lëshojnë edhe grupe të tjera të qenve endacakë. Fatkeqësisht nuk e kemi ende një plan kombëtar për trajtimin e tyre. Komuna jonë, për tri vjet ka ndarë mbi 100.000€ për trajtimin e qenve endacakë dhe shpresojmë që do të kemi shembuj të tjerë të komunave që na rrethojnë. Deri më tani janë të trajtuar 321 qenë endacakë dhe sipas kësaj kontrate duhet të trajtohen edhe 679 të tjerë.

Shaip Shala: Sinqerisht më vije mirë që në 4 ose 5 muajtë e fundit, në qytet nuk kam parë asnjë qen endacak. E pyesja veten duke thënë: vallë mos kanë shkuar te Përparim Rama në Prishtinë, i cili po i adopton.

5. Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje:

Kryetari: Kjo pikë u trajtua më herët, por nëse ka dikush diçka rreth kësaj, le ta marrë fjalën. Unë jam për organizimin e një tryeze ku janë inspektorët, prokurorët, gjyqtarët, policia, OSBE-ja. Të bëhet raportimi te organet kompetente nëse ka rritje të dhunës dhe të diskutohet plani i veprimit për parandalimin e dhunës në përgjithësi dhe dhunës në familje në veçanti.

6. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme:

Fazli Morina: Aktivitetet që i kemi në vazhdim gjatë vitit 2024: është bërë planifikimi i mbajtjes së ligjëratave në të gjitha shkollat me tema të ndryshme. Një projekt tjetër është edhe “Fëmijë të festojmë së bashku 2024”, një nismë e veçantë e PK-së. Nga zyrtarët policorë është realizuar shpërndarja e 39 pakove të dedikuara si dhurata për fëmijët, për festat e fundvitit në qytetin e Rahovecit. Dhuratat janë shpërndarë në lagjen multietnike, duke përfshirë edhe komunitetin rom, ashkali, egjiptian dhe serb. Shpërndarja ka vazhduar edhe te Shoqata “Hareja” – fëmijëve me nevoja të veçanta, fëmijët që u hasën në rrugë dhe në vetura gjatë kontrollit në trafik.

Kryetari: Në gjysmën e parë të muajit shkurt, do të kujdesemi që ta organizojmë një takim me drejtorë të shkollave, kryetarë të këshillave drejtues të shkollave dhe me koordinatorë të cilësisë, të pranishëm do të jenë edhe policia dhe psikologët. Tema do të jetë: Trajtimi i çështjes së sigurisë në shkolla dhe masat parandaluese që, gjithashtu, ta kemi edhe sigurinë që punën tonë po e bëjmë mirë. Do të flasim edhe për kamerat e sigurisë në shkolla dhe për ndonjë rrethojë që mund t’i ndihmojë shkollës si instrument mbrojtës. Bartja e mjeteve të rrezikshme, mund të jetë një nga temat në mbledhjen me drejtorët e shkollave. P.sh. kryetari i Podujevës e ka ndaluar përdorimin e telefonave në shkollë. Ka 4-5 vjet që unë e kam pasur një ide të tillë, por nuk ka pasur përkrahje. Kjo gjithashtu mund të jetë një temë për diskutim, sepse ndikon direkt në rritje të sigurisë.

Fazli Morina: Përdorimi i substancave narkotike është pjesë e ligjëratave nëpër shkolla. Te bartja e mjeteve të rrezikshme, ne kemi ndërmarrë veprime dhe plane operative. Kemi bërë kontrole dhe bastisje në masë (të autobusëve dhe në hyrje të shkollave). Për bartjen e mjeteve të rrezikshme kemi edhe informacione direkt nga drejtorët dhe arsimtarët (këta të fundit të paktën i kemi udhëzuar se si ta bëjnë një kontroll aty ku dyshojnë). Për një gjë të tillë tani duhet t’i bëjmë kërkesë prokurorisë, prokuroria – gjykatës dhe të jepet një leje që ne mund të fillojmë me bastisje. Është një procedurë që nuk mund ta bëjmë aty për aty.

7. Organizimi i trajnimit për mbrojtje nga zjarri me nxënësit e shkollave:

Kryetari: Kjo pikë për herë të parë është këtë vit, është standard i ri që ne duhet t’i përgatisim fëmijët tanë që të dinë të mbrohen dhe të reagojnë në rrethana të caktuara rreth zjarrit dhe emergjencave të ndryshme. Do ta gjejmë formulën në bashkëpunim me ekspertët dhe policinë dhe do ta organizojmë një trajnim për këtë çështje. Në fund, pjesëmarrësit do të pajisen me certifikata dhe mirënjohje.

Besë Bytyqi: Të nderuar anëtarë të KKS-së! Ashtu siç e tha edhe kryetari, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Rahovecit, jemi në fazën fillestare në përgatitjen e disa trajnimeve me nxënës kryesisht të shkollave të mesme. Pretendojmë që këto trajnime t’i mbajmë në muajin maj dhe prill. Duke kërkuar bashkëpunimin tuaj, KKS-së do ta mbajmë të informuar lidhur me ecurinë e këtyre trajnimeve.

8. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat;

9. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;

Kryetari: Faleminderit! Pikat e teta dhe të nënta vazhdojnë të jenë pika standarde në çdo mbledhje të KKS-së. Për pikën e tetë, vazhdojmë t’i kemi disa kontrata aktive për t’i trajtuar shtretërit dhe do të kujdesemi që në lumenjtë e komunës tonë mos të kemi ujëra të zeza. Për ta dëshmuar këtë që po e them është edhe shembulli që jemi duke i eliminuar ujërat e zeza dhe që po futet kolektori i madh i ujërave të zeza nga Fortesa, deri në

Rahovec. Është duke u betonuar dhe po bëhet një shtrat i mirë. Në hyrje të qytetit i kemi disa sfida me prona, por besoj që do të gjejmë zgjidhje. Do të bëjmë diçka me gropa septike (12 gropa), në një projekt të ri që e kemi fituar nga Bashkimi Evropian. Ndërkaq, impiantin të cilin ne e synojmë, e ka vlerën afër 40 milion €. Po përpiqemi që me trajtimin e shtretërve, ujërat e zeza mos t'i lejojmë të derdhen në lumenj. Kërkoj që inspektorati i mjedisit të kujdeset rreth asaj që nuk është mirë të ketë ujëra të zeza.

Nora Boshnjaku: Faleminderit, kryetar! Të nderuar anëtarë të KKSB-së, si pasojë e shfrytëzimit të rërës – zhavorrit, si nga operatorët legalë ashtu edhe ilegalë, gradimi i lumenjve është duke shkuar në një masë shumë të madhe, duke e tejkaluar edhe kapacitetin normal të rrjedhjes natyrore. Janë vetëm dy inspektorë të ujërave që veprojnë në kuadër të Ministrisë së Mjedisit. Ata, sa herë që kanë pasur aksione, e njoftojnë edhe inspektorin tonë të mjedisit, mirëpo, numri i tyre i vogël i pamundëson që ta kontrollojnë tërë aktivitetin ilegal që ushtrohet konkretisht nga operatorët ilegalë. Në vitin 2021, policia e Kosovës e ka krijuar një njësit për parandalimet e krimeve mjedisore, i cili është në kuadër të krimeve të rënda. Pra, në bashkëpunim me policinë e Kosovës, organizohen aksione të ndryshme për parandalimin e degradimit të lumenjve. Inspektimi do të vazhdojë edhe në vitin 2024, në koordinim me inspektoratin qendror, sigurisht me ftesën tonë, sepse arsyetimin që e marrim nga inspektorati qendror është mungesa e inspektorëve dhe që nuk mund të përfshihet i tërë territori i Kosovës. Sa i përket ndotjes së mjedisit, gjatë vitit 2023 kemi shqiptuar gjithsej 41 gjoba mandatore për mjedis. Numri i kontrolleve inspektuese është 207 dhe sigurisht ne jemi të vetëdijshëm që kjo nuk është e mjaftueshme, por në kapacitetet tona jemi duke u munduar ta bëjmë më të mirën. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe disa operatorë, kemi hequr shumë deponi ilegale, kryesisht me hedhje të gurëve. Kërkoj nga anëtarët e KKSB-së, në rast që e shihni ndonjë rast, është mirë ta denonconi në mënyrë digjitale, në fb-në personal, në faqen ueb të Komunës së Rahovecit, apo në ndonjë numër të inspektorëve. Sa i përket kontrollit të produkteve ushqimore, nuk kemi ndonjë kompetencë në këtë çështje, mirëpo në koordinim me inspektoratin sanitar, zakonisht bëjmë aksione rreth kontrollit të produkteve. Gjatë vitit 2023 janë shqiptuar rreth 34 gjoba.

Kryetari: Një qytetar nga Malësia e Vogël ka marrë gjobë 2000€ për ndotje të mjedisit, duke i hedhur mbetjet shtazore, respektivisht në lumin Drini i Bardhë. Kompania që i dërgon në Zhur (deponi speciale) mbetjet shtazore, tarifën e ka vetëm 5€. Personin që e përmenda, i ka paguar 1000€, sepse dënimin e ka paguar brenda 10 dite. Është detyruar ta pastrojë vendin dhe të gjithë e kanë kuptuar që ai e ka bërë atë gjest. Ju ftoj për konsideratë ndaj natyrës, vetvetes dhe qytetarëve. Ne si Komunë nuk kemi të drejtë ta rrisim numrin e inspektorëve, kjo gjë varet nga Qeveria. Të gjitha informacionet dhe denoncimet që vijnë rreth ndotjes së ambientit, ju garantoj për anonimitet dhe ju ftoj që të na ndihmoni në këtë proces. Te kontrolli i produkteve ushqimore: kemi gjetur mallra të skaduar dhe barna. I kemi dënuar ose kemi kërkuar prej inspektoratit sanitar për reagim. Kompetencat e inspektoratit pothuajse të gjitha janë centralizuar. Me një inspektor të mjedisit që e kemi ne, Metush Ismën dhe me dy të tjerë që i ka shteti i Kosovës, për besë është problem.

Fazli Morina: Po kthehem pak te komunikacioni rrugor, më vije mirë që i përmendët me emra, sepse i përmend edhe unë. U shfaq shqetësimi nga kryetarja e këshillit të prindërve, Erseka. Së pari, nuk e kuptova a ishte shqetësimi për policinë, inspektoratin, për kryetarin e shoqatës së bizneseve, apo për kë? Me sa di unë, lokacioni në fjalë është hapësirë publike dhe nuk më kujtohet nëse ka apo jo vija për parkingje. Një gjë duhet ta kemi të qartë të gjithë, ne e kemi problematikën në hapësirat e qytetit brenda rrugëve ku është shumë e nevojshme, e lëre më të merremi me hapësirat publike ku nuk pengon fare, apo ku është e shënuar për vendparking. E kam shumë të qartë atë pjesë atje dhe e di që është biznes i zyrtarit tonë (Amir Mushla). Personi në fjalë është dashur të pajiset me leje biznesi dhe veprimtaria e tij dihet (autolarje dhe rent). A i ka plotësuar kushtet apo jo për zhvillimin e kësaj veprimtarie? Kërkoj publikisht që me një formë të përbashkët mund ta gjejmë një zgjidhje, të qasemi pak më ndryshe, mirëpo jo vetëm policia. Të evidentohet problemi më saktë dhe të sqarohen rrethanat sepse ne jemi që të asistojmë gjithmonë edhe Drejtorisë së Inspektoratit edhe Kuvendit Komunal.

Kryetari: Ju lutem, po e përsëris. Ftoj Policinë e Kosovës, Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Drejtorinë e Inspektoratit, që të shkojnë në vend të ngjarjes. Detyra e policisë është që mos të lejojë tollovi në trafik, nuk është detyrë e inspektoratit. E dëgjova komandantin që tha: “ne nuk ndërhyjmë përderisa është parking publik”, po atëherë veturat duhet të parkohen mirë, nëse jo, atëherë është punë e policisë. Si kryetar i Komunës dhe si kryesues i KKSB-së, ju ftoj për koordinim dhe bashkëveprim në këtë çështje. Askush askënd nuk po e sulmon, secili i di detyrat dhe kompetencat e veta. Nëse nuk ka vija të parkingut, atëherë faji mbetet te Drejtorja e Shërbimeve Publike. Nëse ka, atëherë parkingu duhet të bëhet në vija. Nuk bëhet fjalë për asnjë akuzë dhe nuk më pëlqeu as qasja e komandantit, as e Norës, sepse nuk jemi këtu kush kujt t’i thotë se sa është kompetent. Nesër në orën 8:00, Komuna dhe dy drejtoritë e Komunës janë të angazhuar në këtë parking.

10. Të ndryshme:

Mustafë Korenica: Faleminderit edhe një herë! Në fillim kam dashur të kyçem me disa pika si kërkesa të bizneseve të Komunës së Rahovecit. Me qëllim e bëra që të flas në pikën e fundit “të ndryshme”. Parafolësja e nderuar e ceku çështjen e rrugës në fjalë. Fillimisht e falënderoj policinë! Në lidhje me parkingun në fjalë, unë shpeshherë ndodh që personalisht e pi ndonjë kafe në kafetaritë aty afër dhe e shoh se çfarë tollovie bëhet. Biznesi me të cilin merret polici në fjalë është për t’u lavdëruar shumë, sepse një polic e mban familjen e tij me një punë që është shumë e vështirë. Ai fare nuk është pengesë e parkingut, përkundrazi, aty është një lehtësim për t’i kthyer veturat në atë kahje prej nga kemi ardhur. Në këtë pikë ne duhet të mendojmë se si të bëjmë zgjidhje aty.

Në shoqatën ku unë veproj, jemi duke e përgatitur një plan bashkë me ekspertët e fushës, rreth urbanizmit të qytetit. Së shpejti do të dalim me disa propozime bashkë me Drejtorinë e Urbanizmit, që fytet e ngushta të qytetit të zgjerohen me rrugë plotësuese, apo rrugë zingjirore. Në këtë pikë konkrete, propozoj: Të bëhet një trupim i rrugës te parku ekzistues dhe të lidhet me rrugën që është njëkahore. Në shumicën e rasteve, gjinia femërore, duke vozitur me vrull, mbesin aty dhe nuk kanë mundësi t’i kthejnë veturat, me këtë rast krijohet tollovia. Nëse e bëjmë këtë plotësim të rrugës, tollovitë do të evitohen, sepse do të bëhet kyçja në rrugën tjetër. Kam edhe disa shqetësime në lidhje me urbanizmin, por në këtë takim nuk jam i gatshëm t’ju elaboroj me fakte dhe me dëshmi se cila është zgjidhja më e mirë.

Kryetari: Faleminderit, Mustafë! Çfarëdo ideje apo plani që e keni, e mirëpresim. Natyrisht, koncepti i idesë duhet të jetë në përputhje me rrethanat dhe sipas ligjit. Sivjet e kemi zgjerimin e rrugës “Gëzim Hamza” dhe duhet të bisedojmë me njërin nga bizneset më prestigjioze që ka komuna jonë, “Bodrumin e Vjetër”. Ideja është që të zgjerohet rruga, të krijohet ndonjë trotuar, sidomos kjo pjesa hyrëse te muri. Në këtë çështje mirë është që të kontribuojnë edhe bizneset, duke kompensuar pronat e tyre, por edhe nëse e falin pronën, mund të përfitojnë, sepse zgjerimi i fyteve të ngushta hap rrugë. Te biznesi i policit, tek autolarja, unë personalisht e pastroj veturën, sepse ata djemtë punojnë mirë. Problemi është që ka pasur situata të paqarta, që kanë ardhur deri tek unë. E rëndësishme është që edhe KKSB-ja nxjerr disa rekomandime. E ftoj Skenderin që këto rekomandime të nxjerra, t’i artikulojë mirë, sepse mund të kthehen edhe në vendime. Nga KKSB-ja ka dalë vendimi që t’i mbyllim lokalet e natës. I kemi shfrytëzuar diskutimet dhe është marrë vendimi që, pas orës 23:00, nuk duhet të funksionojnë. Pra, KKSB-ja luan rol të rëndësishëm. Faleminderit të gjithëve për kontributin!

Mustafë Korenica: E kam një propozim në lidhje me infrastrukturën. Në qendër të Rahovecit është punuar mirë, ashtu siç e keni paraparë ju si qeveri lokale. Për t’i ikur fytit të ngushtë, kur ka frekuentim më të madh të veturave, kemi menduar që rruga (nuk e di me emër si thirret) te parku i vogël në qendër, të hapet dhe të lidhet, të ketë dalje në anën tjetër deri te varri (statuja) i Sheh Myhedinit. Kjo është një kërkesë e bizneseve dhe do t’ia lëmë urbanizmit të mendojë rreth kësaj dhe të japë një udhëzim të duhur. Tjetra, e prita të jetë i pranishëm edhe drejtori i Shërbimeve Publike. E kam një plotësim në lidhje me të njëjtin semafor që dikur kemi diskutuar këtu

rreth problemeve që i ka pasur. I kam faktet me foto që aty kanë filluar ta demolojnë përsëri semaforin dhe kabllot optik. Afër është edhe kapaku i thyer i pusëtës, që dikush si këmbësor mund edhe të lëndohet gjatë natës. Plotësim tjetër është që njehsorët elektrikë nëpër shtylla elektrike në atë rrugë janë të hapur. Nuk e di se kush është përgjegjës për këtë, por duhet të jetë kujdesi më i përgjithshëm.

Kryetari: Faleminderit, Mustafë! Për këtë të fundit është KEDS-i. E kemi pasur një takim me udhëheqësit kryesorë të KEDS-it dhe kemi diskutuar për disa tema shumë të rëndësishme. Eliminimi i vonesave dhe i burokracive që i kanë dhe besoj që jemi marrë vesh. Sivjet do të kemi më shumë aktivitete për të mirën e përgjithshme. Kërkesat që i pate për infrastrukturë, besoni që janë tema të përditshme të diskutimit në nivel komune. Kushdo që ka ide, do të përpiqemi t'i përgjigjemi dhe ta japim kontributin tonë. Ju falënderoj edhe një herë të gjithëve për kontributin!

Procesmbajtësi

Albion Krasniqi

Kryetari i Komunesë

Smajl Latifi

